

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2025/2026

(java e nëntë, deri më 23.02.2026-01.03.2026)


TË DHËNA JAVORE

Gjatë javës së nëntë të vitit 2026 (nga 23.02-01.03.2026) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 767 ($I=41,7/100.000$) raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 31,1% më pak se javën që shkoi (1.113).

Në javën e nëntë të vitit të kaluar janë regjistruar 2.569 të sëmurë (rënie për 70,1%), ndërsa krahasuar me modelin për 15 sezonet e fundit (963) është regjistruar një rënie prej 20,4%.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit gjatë javës së nëntë është në kufirin e aktivitet të ulët të virusit të gripit.

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike 2010-2025, sezoni 2024/2025 dhe sezoni 2025/2026




Sa i përket grupmoshës, tek grupmosha nga 15-64 vjet janë regjistruar 430 të sëmurë, ndërsa tek grupmosha mbi 65 vjet – 123, tek grupmosha 5-14 vjet - 110 dhe tek grupmosha 0-4 vjet – 104 të sëmurë. Incidencë më e lartë ($107,7/100.000$) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Personat e sëmurë të kësaj jave janë regjistruar në 22 QSHP/NJR, pra në Shkup – 447, Prilep – 45, Tetovë – 45, Strumicë – 39, Shtip – 30, ndërsa në qytetet e tjera numri i të sëmurëve është nën 30. Në 9 qytetet nuk janë raportuar raste të të sëmurëve nga gripin.

Në 13 njësi aktivitet sezonal, ndërsa në 9 është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit.

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit dhe incidenca në 100.000 banorë, jave nëntë, 2026



Mbikëqyrja virologjike

Gjatë javës së nëntë të raportimit pranë pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 72 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Nga materialet e testuara 4 kanë rezultuar pozitiv për prani të virusit të gripit - 2 Influenza A(H1)pdm09 dhe nga 1 Influenza A(H3) dhe Influenza A e pasubtipizuar.

Janë regjistruar 6 raste pozitive me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar edhe 22 raste pozitive me RSV.

МБИКЌЫРЈА ЕРІДЕМІОЛОГЈКЕ - ТЋ ДНЃНА КУМУЛАТІВЕ


Гјатјј сезонит 2025/2026 нумри і пјргјитшшјм і тј прекурве нга грпї/сјмундје тј нгјашме ме грпїн јштј **15.751 (I=857,6/100.000)**.

Крахасуар ме перїуднјн е нјјтј тј сезонит тј калуар (n= 19.944) нумри і растеве тј рапортуара јштјј звогјлуар пјр 21,0%, ндјрса крахасуар ме моделін пјр 15 вїтет е фундїт (n= 19.017) јштјј регїструар нјј рјніе прјј 17,2%.

Тј сјмурјј јанј регїструар нј тј гјїта QShP/NjR. Нумри мј і мадх і тј сјмурјј (n=5.379) јштјј регїструар нј Шкуп, ндјрса інциденцј мј е лартј кумулатїве (I=2.503,7/100.000) нј Дїбјр (n=479).

Са і пјркет шпјрндарјјс тј тј сјмурјјс сїпас групмшјс, нумри мј і мадх і тј сјмурјјс бјјнј пјсј нј групмшјн қј пјрфшїн нумрїн мј тј мадх тј попультјс (нга 15-64 вјет) – 9.094 расте (57,7%), ндјрса інциденцј мј е лартј (1.931,2/100.000) јштјј регїструар тек групмосха 0-4 вјет дје тек групмосха нга 5-14 вјет (1.271,7/100.000).

Графїку 2. Шпјрндарја е растеве ме грпї сезонал сїпас QSH/MJR дје інциденца нј 100.000 банорјј, сезонї 2025/2026



Шпјрндарја е растеве сїпас муајје:

- тетор – 338 расте осе 2,1%
- нјнтор – 438 расте осе 2,8%
- дїјетор – 1.324 расте осе 8,4%

- janar – 9.135 raste ose 59,1%
- shkurt – 4.336 raste ose 27,5%

Deri më tani janë regjistruar 4 raste të vdekjes si pasojë e gripit.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE – TË DHËNA KUMULATIVE

Deri më tani në sezonin 2025/26, pranë laboratorit të virologjisë në Institutin e Shëndetit Publik të RMV-së kanë arritur 877 materiale nga mbikëqyrja rutinore dhe SARI për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuara për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.


Janë zbuluar 120 raste pozitive të gripit:

- **Influenza A – 120**
 - Influenza A(H1)pdm09 – 37 (30,8%)
 - Influenza A(H3) – 69 (57,5%)
 - Influenza A – e pasubtipizuar – 14 (11,7%)
- **Influenza B – 0**

Janë regjistruar 19 rezultate pozitive për SARS-CoV-2 dhe 102 pozitive për RSV.

Janë detektuar edhe 5 viruse të tjerë respiratorë tek mostrat e testuara.

Grafiku 2. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes të mostrave pozitive të gripit, mbikëqyrja rutinore dhe sentinel, RMV, 2025/2026



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vazhdon rënia e numrit dhe incidencës të sëmundjeve të ngjashme me gripin në nivel javor, numri i rasteve të raportuara . Gjatë javës së nëntë është regjistruar aktivitet i ulët i virusit të gripit në vendin tonë. Rezultatet e fituara nga mbikëqyrja virologjike tregojnë se ka një përhapje rajonale të virusit të gripit. Përqindja e ratseve pozitive për katër javë me radhë është mbi 10%.

Sipas të dhënave të pranuar në Maqedoni ka një intensitet mesatar të virusit të gripit.

MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

*Burimi: <https://sezonskigrip.mk/>

Masat e përgjithshme për mbrojtje nga gripi kanë për qëllim parandalimin e të gjitha sëmundjeve akute të frymëmarrjes dhe mund të jenë shumë të dobishme, veçanërisht nëse zbatohen gjatë gjithë periudhës së dimrit:

- Evitoni grumbullimin dhe qëndrimin në dhoma ku qëndrojnë më shumë njerëz, sidomos kontaktin e ngushtë me njerëz që janë të sëmurë ose që kolliten, teshtijnë, kanë temperaturë të lartë të trupit.
- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose me dezinfektues.
- Ngrohni dhomat në të cilat qëndroni dhe ajrosini ato shpesh.
- Këshillohet të vishni rroba të ngrohta, në disa shtresa, të bëni banjo të ngrohta.
- Pini pije të nxehta (çajra dhe supa), lëngje frutash, ujë me limon.
- Hani produkte të freskëta të pasura me vitamina dhe minerale, më së miri fruta dhe perime që janë më të mira e të nevojshme për trupin. Produktet e pasura me vitaminë C (limona, portokalle) janë veçanërisht të dobishme. Nëse produktet ushqimore të freskëta nuk janë gjithmonë të disponueshme, mund të përdoren edhe pije dhe preparate multivitaminike.
- Praktikoni një stil jetese dhe zakone të shëndetshme, duke përfshirë këtu gjumin dhe pushimin e mirë, të ushqyerit e shëndetshëm, ruajtjen e aktivitetit fizik dhe mendor dhe uljen e stresit.

Sistemi i fortë imunologjik do t'ju ndihmojë të qëndroni të shëndetshëm ose ta përballoni më lehtë gripin dhe sëmundjet e ngjashme me gripin. Megjithatë, edhe nëse jeni plotësisht të shëndetshëm dhe keni një sistem imunologjik të fortë, prapëseprapë mund të sëmureni me grip ose një sëmundje të ngjashme me gripin.

Çfarë duhet të bëni nëse sëmureni nga gripi?

Ndiqni këto rekomandime:

- Qëndroni në shtëpi dhe mos shkoni në punë, shkollë ose në vende ku ka shumë njerëz.
- Pushoni dhe konsumoni shumë lëngje dhe ushqime të lehta.
- Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit me të cilët jetoni, mos pranoni vizitorë ndërsa jeni të sëmurë.
- Mbuloni hundën dhe gojën me një pecetë kur kolliteni dhe teshtini. Pas përdorimit, hidhni ato në plehra.
- Mbani maskë mbrojtëse kur kontaktoni me të afërmit tuaj në shtëpi, kur kolliteni dhe teshtini.
- Praktikoni larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- Përdorni peceta të lagta që përmbajnë alkool ose dezinfektues për pastrimin e duarve.
- Shmangni preken e syve, hundës dhe gojës me duar.
- Ajrosni shpesh dhomën ku qëndroni gjatë kohës që jeni të sëmurë.

- Mbajeni mjedisin tuaj të pastër - objekte, sipërfaqe, me produkte higjienike shtëpiake.
- Nëse jeni mbi 65 vjet ose keni sëmundje kronike, ose nëse simptomat e sëmundjes përkeqësohen ose zgjasin për disa ditë - kërkon ndihmë mjekësore.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

- ❖ Për sezonin 2025/2026, Ministria e shëndetësisë siguroi 80.000 doza të vaksinë katërvalente falas për grupet prioritet të popullatës.

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 16.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vakcinacija.mk.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike, nga fillimi i vaksinimit e deri në përmbylljen e këtij raporti **gjithsej janë vaksinuar 77.280 persona të kategorive të cënueshme të popullatës me vakcina falas.**

- ❖ 2.400 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike **me vakcina komerciale janë vaksinuar gjithsej 1.839 persona.**

Në Maqedoninë e Veriut janë vaksinuar gjithsej 79.119 persona me vakcina falas dhe vakcina komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Sipas Raportit të ERVISS të publikuar në javën e tetë të vitit 2026:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute (ARI) është rritur mbi nivelet bazë në 15 nga 32 vendet rajonit evropian të OBSH-së që raportojnë.
- Indikatorët rajonalë për gripin, si në mbrojtjen shëndetësore primare ashtu edhe në atë sekondare vazhdojnë të pësojnë rënie nga nivelet e rritura më parë gjatë sezonit, me ulje të qarta të vërejtura në të gjitha vendet, përveç një numri të vogël prej tyre. Influenza A(H3) mbetet virusi dominues qarkullues në të gjithë Rajonin, ndërsa të rriturit e moshës 65 vjeç e lart përbëjnë përqindjen më të lartë të personave me pasqyrë të rëndë klinike të gripit.
- Indikatorët rajonalë të aktivitetit të SARS-CoV-2 mbeten në nivel bazik.

- Indikatorët rajonale për RSV me sa duket po stabilizohen në nivele të larta. Megjithatë, në rajon variojnë trendet dhe në vende të caktuara aktiviteti ende shënon rritje. Ngarkesa e sëmundjes dhe përqindja e rasteve pozitive mbeten më të larta tek fëmijët e moshës deri në 5 vjet.

***Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik***